REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE ASETEVE
ZYRA E STREHIMIT

Nr. 1068 prot

Maliq më 19/2/2026

PROJEKT-VENDIM – Nr. 13
PËR
PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIM DHE LISTËS SË PËRFITUESVE, TË PROJEKTIT "PËRMIRËSIMI I BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA", VITI 2026

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika1.1/b, neni 24 pika 1.2, ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*", i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, datë 22.6.2023, neni 40, 41, 42, 43, VKM nr.454, datë 3.7.2019 "*Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese*", Udhëzim-it Nr. 31, datë 18.11.2019 "*Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit*" si dhe shkresës tuaj nr.628/2 Prot datë 23.01.2026 "*Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2026*" , Këshillit Bashkiak i

PROPOZOJMË

1. Të miratojë në parim deklaratën për bashkëfinancim të projektit "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara, viti 2026, me vlerë totale 59,625,669.89 (pesëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjet e nëntë pikë tetëdhjetë e nëntë) lekë me TVSH, me bashkëfinancim 20% bashkia Maliq në vlerën 11,925,133.98 lekë dhe 80% Buxheti i Shtetit në vlerën 47,700,535.91 lekë, me mbështetjen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.
2. Të miratojë në parim listën e familjeve përfituese nga projekti "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara", për vitin 2026 sipas tabelës Nr.1 bashkëngjitur.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Finances dhe Buxhetit dhe Sektori i Strehimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar.

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Tabela Nr.1
Lista e përfituesve nga projekti i përmirësimit të banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pa favorizuara" për vitin 2026.

Nr	Emër/ atësi mbiemër	Adresa	NJ.Ad
1	Hatixhe Xhafer Zaçe	Drithas	Libonik
2	Shqiprije Rexhep Krekas	Maliq	Maliq
3	Jonuz Bahri Dushku	Maliq	Maliq
4	Nizaqet Ismail Koka	Leminot	Pirg
5	Margarita Faik Agushi	Libonik	Libonik
6	Hetem Avni Skendo	Libonik	Libonik
7	Besnik Myslim Mirashi	Maliq	Maliq
8	Dritan Bajram Muka	Maliq	Maliq
9	Bashkim Axhem Çekrezi	Maliq	Maliq
10	Bajram Mustafa Çelniku	Maliq	Maliq
11	Besnik Hodo Kellezi	Maliq	Maliq
12	Vasil Kristaq Grabocka	Maliq	Maliq
13	Luan Selami Mete	Maliq	Maliq
14	Denis Osman Manoku	Orman	Pojan
15	Memli Hysni Spaho	Orman	Pojan
16	Kristo Muharem Hamit	Orman	Pojan
17	Krenar Petrit Xhafllari	Pirg	Pirg
18	Shkëlqim Agim Ibrahimaj	Pirg	Pirg
19	Mentor Samit Latifi	Plase	Pojan
20	Dritan Jaçe Balliu	Plase	Pojan
21	Irma Agim Shkëmbi	Poceste	Libonik
22	Rami Shaqir Poçka	Podgorie	Vreshas
23	Neiron Kamber Adri	Podgorie	Vreshas
24	Edmont Demir Lëngu	Pojan	Pojan
25	Stefan Osman Jonuz	Pojan	Pojan
26	Adem Hekuran Ibrahim	Pojan	Pojan
27	Petrika Gaqo Qirio	Rembec	Pojan
28	Fuat Nesim Sala	Shengjergj	Pojan
29	Kristo Shefki Oranlli	Shengjergj	Pojan
30	Kujtim Shyqyri Dervisha	Sheqeras	Vreshas
31	Arben Xhuma Terolli	Sheqeras	Vreshas
32	Shkëlqim Fatmir Nakoleci	Sheqeras	Vreshas
33	Bashkim Nezir Hoxha	Shqitas	Pirg
34	Olsi Demir Sari	Shqitas	Pirg
35	Muhamer Sani Rusi	Sovjan	Pirg
36	Arben Orhan Hyska	Sovjan	Pirg
37	Agim Shukri Malo	Sovjan	Pirg
38	Naxhije Izet Elmas	Vashtemi	Libonik

39	Islam Elmas Elmasi	Vashtemi	Libonik
40	Rexhep Kasem Agolli	Vashtemi	Libonik
41	Manushaqe Beqir Çami	Vashtemi	Libonik
42	Hurma Qemal Hysollari	Vashtemi	Libonik
43	Altin Hydai Agolli	Vashtemi	Libonik
44	Eduart Shaban Avdolli	Vashtemi	Libonik
45	Aleks Rakip Harif	Vashtemi	Libonik
46	Ilir Rakip Harif	Vashtemi	Libonik
47	Robert Avni Emin	Vashtemi	Libonik
48	Mehdi Faik Cenolli	Vashtemi	Libonik
49	Denisa Bardhyl Mero	Vashtemi	Libonik
50	Roland Avni Dushku	Veliterne	Pirg
51	Miranda Bexhet Kreka	Vlocisht	Libonik
52	Flamure Kamber Zere	Vlocisht	Libonik
53	Bledian Skender Fidani	Vlocisht	Libonik
54	Nazar Vasfi Jasharllari	Vlocisht	Libonik
55	Shqiprije Tefik Braho	Vlocisht	Libonik
56	Sefer Vasfi Jasharllari	Vlocisht	Libonik
57	Gazmon Isuf Bujari	Zemblak	Pojan
58	Vasfi Selami Hoxhalli	Zemblak	Pojan
59	Aleksandri Luan Rushit	Zemblak	Pojan
60	Zeqire Sherif Kolami	Zvezde	Pojan
61	Barjame Telha Hysenllari	Zvirine	Pirg
62	Bardhyl Hamet Lilollari	Zvezde	Pojan

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE ASETEVE
ZYRA E STREHIMIT

Nr. 1068 prot Maliq më 19/2/2026

RELACION MBI
PROJEKT-VENDIMIN
PËR
PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIM DHE LISTËS SË PËRFITUESVE, TË PROJEKTIT "PËRMIRËSIMI I BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETE TË VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA", VITI 2026

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" i ndryshuar neni 8 pika 1 dhe 2, neni 9 pika1.1/b, neni 24 pika 1.2, ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*", i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, datë 22.6.2023, neni 40, 41, 42, 43, VKM nr.454, datë 3.7.2019 "*Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese*", Udhëzim-it Nr. 31, datë 18.11.2019 "*Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit*" si dhe shkresës tuaj nr.628/2 Prot datë 23.01.2026 "*Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2026*".

Projekti "Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara" mbështetet dhe hartohet bazuar ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*" i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, datë 22.6.2023.
Neni 40 pika 2. Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese private ose pronë shtetërore nënkupton ndihmën që u jepet, me grante konkurruese, njësive të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit për këtë qëllim.
Neni 41 pika 1. Objektet dhe banesat, që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve, janë:
a) objektet/banesat në rrezik shembjeje;
b) objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme.
2. Administrimi i kërkesave dhe identifikimi i ndërhyrjeve për përmirësimin e kushteve të objekteve/banesave ekzistuese duhet të bëhet nga struktura përkatëse e njësisë së vetëqeverisjes vendore.
Neni 42 pika 1. Programi për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese realizohet nëpërmjet grantit konkurrues për:
a) përmirësimin e kushteve të banimit e jetesës, deri në ndërtim të ri, për banesat në rrezik shembjeje;
b) përmirësimin e kushteve të banimit në banesat e amortizuara;
c) rregullimin e banesave individuale ose strukturave, të cilat nuk klasifikohen si banesë, nga vetë familjet që nuk sigurojnë të ardhurat e nevojshme për ta kryer vetë përmirësimin.
2. Kriteret dhe procedurat e përfitimit dhe dhënies së granteve konkurruese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
Neni 43 pika 1. Nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit, si dhe përmirësimit deri në ndërtim të ri përfitojnë familjet/individët, të cilëve u mungon një strehim i përshtatshëm.

2. Përparësi në trajtimin me këtë program kanë:
a) personat me aftësi të kufizuara;
b) individët me statusin e jetimit;
c) familjet e policëve të rënë në detyrë;
ç) të moshuarit;
d) komuniteti rom;
dh) komuniteti egjiptian;
e) komunitetet e zonave rurale;
ë) prindërit e vetëm;
f) viktima të trafikimit /viktima të mundshme të trafikimit;
g) viktima të dhunës në familje.

Deklarata për bashkëfinancim mbështetet në Udhëzim-in Nr. 31, datë 18.11.2019 "Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit" si dhe shkresës nr.628/2 Prot datë 23.01.2026 "Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2026", ku bashkëfinancimi është kusht që bashkia të kualifikohet për të aplikuar në këtë program strehimi.

Udhëzim-it Nr. 31, datë 18.11.2019 "*Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit*":
Pikat:
6. Aplikimi për të përfituar nga fondet buxhetore të vitit korrent respekton edhe rregullat si më poshtë:

c) për të përfituar fonde investimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet t'i përgjigjen thirrjes që shpall ministria përgjegjëse për strehimin, ku përcaktohen afatet kohore për dorëzimin e projekteve, dokumentacioni që duhet të dorëzojë njësia e vetëqeverisjes vendore, informacioni që duhet të shoqërojë aplikimin, kriteret skualifikuese dhe sistemi i pikëzimit për kualifikimin e fituesve të garës.

7. Kufijtë e financimit nga buxheti i shtetit, për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, janë në varësi të të ardhurave për frymë, sipas tabelës nr. 3, dhe në raport të drejtë me numrin e aplikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore përkundrejt totalit të aplikimeve në shkallë vendi.
Në rastin e bashkisë Maliq kufiri për financim nga buxheti i shtetit është 80% dhe 20% duhet ti përballojë vetë bashkia.

Në zbatim të kuadrit ligjor, Bashkia Maliq me shkresë Nr. 596 datë 06.02.2025 hapi thirrjen për aplikim për të gjitha programet e strehimit social në të cilat bën pjesë edhe përmirësimi i banesave. Në zbatim të ligjit 22/2018 "Për strehimin Social" i ndryshuar neni Neni 41 pika 2. ku thuhet se: Administrimi i kërkesave dhe identifikimi i ndërhyrjeve për përmirësimin e kushteve të objekteve/banesave ekzistuese duhet të bëhet nga struktura përkatëse e njësisë së vetëqeverisjes vendore si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 139 datë 26.11.2025 "Për Miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit dhe përcaktimin e nivelit maksimal të subvencionit të qirasë" Shtojca b) pika 1. Verifikimi në terren dhe përzgjedhja e familjeve për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, të bëhet nga Grupi i Punës, i ngritur nga Kryetari i Bashkisë, me Urdhër të posaçëm, duke u mbështetur në ligjin 22/2018 "*Për Strehimin Social*", *i ndryshuar me ligjin nr. 48/2023, datë 22.6.2023.* Nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit, si dhe përmirësimit deri në ndërtim të ri përfitojnë familjet/individët, që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë fare të ardhura të cilëve u mungon një strehim i përshtatshëm. Objektet dhe banesat që trajtohen nga programi i përmirësimit të kushteve, janë:

a) objektet/banesat në rrezik shembje;
b)objektet/banesat e amortizuara, që kanë nevojë për ndërhyrje dhe përmirësime të domosdoshme.
Me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Maliq, nr.554, datë.01.10.2025, u ngritën Grupiet e punës për verifikimin e banesave, të aplikantëve për programin (Përmirësimi i Kushteve të Banesave Ekzistuese)" për secilën njësi administrative. Grupet e Punës kryen verifikime në terren të gjendjes reale të rreth 180 banesave të aplikantëve, shqyrtuan dokumentacionin ligjor dhe social-ekonomik, mbajtën për çdo rast akt-verifikimi dhe dokumentacion fotografik. Në fund të procesit të verifikimit grupet e punës sipas çdo njësie administrative, klasifikuan aplikantët në bazë të kritereve ligjore të nenit 16 të ligjit nr. 22/2018 i ndryshuar.
Nga verifikimi i kryer rezultoi se një pjesë e aplikantëve nuk plotësojnë kushtet ligjore, për arsye se: banesa është në gjendje të mirë, është e braktisur, familje që nuk jetojnë realisht në objekt, posedim i më shumë se një banese, mungesë dokumentacioni pronësie etj.
Një numër i konsiderueshëm familjesh plotësojnë kushtet ligjore dhe klasifikohen si, familje me të ardhura të pamjaftueshme ose pa të ardhura, familje që jetojnë në banesa të amortizuara ose në rrezik shembjeje dhe që kanë nevojë për ndërhyrje të domosdoshme.
Nga familjet që plotësojnë kushtet ligjore, Grupet e Punës sipas njësive administrative, kanë përzgjedhur, familjet që propozohen të përfshihen në projektin e vitit 2026, të renditura sipas prioritetit social dhe nivelit të nevojës nisur nga gjendja e banesës.

Familjet e përzgjedhura paraprakisht nga komisionet përkatëse u njoftuan për plotësim dokumentacioni pronësor në të gjithë territorin, bazuar ligjit 22/ 2018 "*Për strehimin social*", *i ndryshuar* si dhe shkresës Nr. 628/2 datë 23.01.2026 "*Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2026*" e cila në përmbajtjen e saj ka termat e referencës për aplikim të miratuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.
Për të mos përjashtuar asnjë familje, bashkia Maliq ka lënë afatin maksimal të mundshëm për plotësimin e dokumentacionit, duke e dorëzuar projektin në ditën e fundit të përcaktuar nga MEI. Vetëm familjet bashkëngjitur këtij projekt-vendimi plotësuan dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar si dhe kriteret ligjore.
Familjet përfituese nga ky projekt janë të kategorive të ndryshme social ekonomike si, kanë të ardhura të pamjaftueshme ose mungesë të plotë të të ardhurave, jetojnë në banesa, në rrezik shembjeje, të amortizuara, që kërkojnë ndërhyrje të domosdoshme.
Këto familje i përkasin kategorive të nenit 16 të ligjit nr. 22/2018 "*Për strehimin social*", i ndryshuar, një pjesë e konsiderueshme e familjeve janë në Ndihmë Ekonomike, kanë persona me aftësi të kufizuar, familje të moshuara, ka familje nga komunitetet rom dhe egjiptian, familje njëprindërore, etj.
Duke qënë se kërkesat janë të larta bashkia Maliq është e angazhuar të aplikojë për këtë projekt, pranë Ministrisë përgjegjëse për strehimin edhe në vitet në vazhdim.
Me qëllim aplikimin pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për tju ardhur në ndihmë këtyre familjeve propozojmë miratimin në parim të këtij projekt-vendimi.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim TOPÇIU